

N.P.K TRAFIKU URBAN, PRISHTINË

N.P.K "Trafiku Urban" ka blerë 51 autobusë të rinj nga kompania çeka "Iveco". Kjo është mundësuar përmes kredisë së dhenë nga Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim - BERZH (EBRD), si dhe përmes Komunës së Prishtinës e Ministrisë së Financave, si garantuese të kësaj kredie.


Autobusët tanë qarkullojnë në linjat 1, 3, dhe 4.



Për rregullim të objektit në Bazën Teknike, Komuna e Prishtinës ka financuar "Projektin e Renovimit të Garazheve të Trafikut Urban". Sipas marrëveshjes me Komunën e Prishtinës, të liruar nga pagesa e biletës janë pensionistët dhe anëtarët e Shoqatës HANDIKOS dhe "Trafiku Urban" është duke shqyrtuar mundësitet edhe për kategoritë me asistencë sociale.



Autobusët tanë ofrojnë për qytetarët e Prishtinës me rrethinë udhëtim të sigurt, komoditet, monitorim brenda autobusit me anë të kamerave, ajër të kondicionuar, ventilim e pastërti. Gjithashtu autobusët tanë janë të përshtatshëm për udhëtime me fëmijë dhe persona me nevoja të veçanta (me karrocë). Për të ofruar sa më tepër shërbime cilësore ndaj qytetarëve, "Trafiku Urban" organizon trajnime të stafit, e veçanërsht për shoferë dhe konduktore.




Autobusët e "Trafikut Urban" janë të standardit Europlan E6 për ruajtjen e ambientit. "Projekti i Renovimit të Garazheve të Trafikut Urban" ka trajtuar ndikimin në mjedis. Në këtë projekt është përfshirë trajtimi i ujërave të jashtme, uji atmosferik, uji i larjes së autobusëve duke ndërtuar kolektor (ujëmbledhës), montim të filtrave, ku pas filtrimit nga vajrat do të shkarkohet në sistemin e kanalizimit të qytetit. Për pastrimin e autobusëve përdoret uji nëntokësorë nga pusë pranë Bazës Teknike.



Renovimi i garazheve dhe objektit të administratës krijon kushte shumë të mira për të punësuarit në NPK "Trafiku Urban". Ambienti i pastër dhe higjenik me nyje të reja sanitare. Punët e planifikuar :

- Kolektori i ujërave teknike dhe ndarësi (filtr) i vajrave dhe derivateve.
- Mbjellja e fidanëve të reja rreth Bazës Teknike të TU.
- Hapja e puseve të reja për ujitje të fidanëve.

Vajl i përdorur pas servisimit të autobusëve deponohet në rezervuarin e vajrave të përdorur dhe pastaj jepet për riciklim.



Për ngritjen e performancës operative në ndërmarrjen "Trafikut Urban" bazuar në statistika dhe analiza, na ndihmojnë edhe kompanitë konsulente të finançuara nga BERZH (EBRD) siç janë : aspiro , bnv dhe RECURA përmes projektit FOPIP.

Me projektin për lidhjet Urbane nga kompania MOTT MACDONALD përmes projektit SUMP do të lehtësohet qarkullimi i autobusëve tanë, do të ketë më tepër siguri për qytetarët dhe më pak ndotje të ambientit.

Kontakti:

- 📍 Rr. Tahir Zajmi, Prishtinë.
- 📞 +383 (0) 45 10 11 22
- ✉️ info@trafikurban-pr.com
- 🌐 http://www.trafikurban-pr.com
- 👤 fb.com/trafikurban

